

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Siparantumin" dhe "Charitéchor Berlin" i bashkon në Pejë muzika e diplomacia
ADRESA	https://www.koha.net/kulture/siparantumin-dhe-charitechor-berlin-i-bashkon-ne-peje-muzika-e-diplomacia
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 01:37:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 12:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	571f2b74bd59571033d58a7067ee7603dd4de0753762756091a9957139530463
TEKSTI	369e9154ebc1c9065618e594f2af8c61b22ef1922eb548cc321338913cfc634e
PAMJA	946ebffeff1dce74c20e65ae1604425a7ac24180e77c26ce2a462323049e2418

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3633defbd421cd3fe39e8fda77e2d774f637000de3dda974ab179851d48e7da5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	339a441950953cdd8a76a2c095ab2238d5bab62fcc252abcef1242a6a5fba2fb
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3633defbd421cd3fe39e8fda77e2d774f637000de3dda974ab179851d48e7da5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KULTURË

“Siparantumin” dhe “Charitéchor Berlin” i bashkon në Pejë muzika e diplomacia



Kori nga Gjermania ia ka mësyre skenës menjëherë pasi “Siparantum” ka përshëndetur publikun. Kanë nisur me “Baladën e fyellit” të Ramadan Sokolli për të vazhduar me “Ojano” të Clifford W. King (Foto: Kori Siparantum)

Nga: Shaban Maxharraj



14 shtator 2026 14:00

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Mbase ka shumë, por në aspektin kulturor Peja ka një aset që s'ia di vlerën: korin “Siparantum”. Kur praktikisht Peja s'ka teatër ose e ka në gjendje “kome”, e Galeria nganjëherë lëshon ndonjë “grahmë”, jeta kulturore e qytetit perëndimor ka dy adresa: Festivalin e animacionit dhe korin “Siparantum”. Të shtunën mbrëma për herë të tretë sivjet “Siparantum” qe nikoqir i një kori Evropian. Në maj në Pejë bashkë me “Siparantum” koncertoi “ARTyn Choir” nga Lituania, në korrik, “Defrost Youth Choir” nga Norvegjia. E tash, “Charitéchor Berlin” nga Gjermania. Krejt bashkë janë kore vullnetarësh që i bashkon muzika. E për ata, Peja është një qytet që e do muzikën, pasi janë takuar me “Siparantum” nëpër Evropë e Botë. E kanë njohur Kosovën e veçanërisht Pejën nëpërmjet muzikës. Nëpërmjet asaj që “Siparantum” ka rrëfyer me art. Por Peja duket sikur s'e ka kapur këtë.

Me rreth 70 veta në publik në kishën katolike “Shën Katerina” në Pejë, “Siparantum” dhe “Charitéchor Berlin” kanë mbajtur koncertin e përbashkët. Prej këtij publiku, afro 10 veta qenë mysafirë nga qytetet e tjera. Komuna e Pejës duhet ta përdorë këtë mundësi që nëpërmjet “Siparantum” të fusë në lojë diplomacinë kulturore. Sikur të mendohej vetë t'i sjellë tri kore ndërkombëtare do të shpenzonte alamet energjie në kontakte dhe mijëra euro. Që të tria koret kanë ardhur me financa të vetat si formacione vullnetare. Përtej “cic-miceve” lokale, zënkave të ulëta e inateve si ajo me meritat e ardhjes së “ARTyn Choir”, institucioni lokal duhet të mendojë ndryshe. Të mendojë sikurse mysafirët e “Siparantum”.

“Jemi takuar nëpër festivale e tash jemi në Pejë. Muzika na bashkon dhe kjo ndodhi. U kënaqëm në Pejë e në koncert”, ka thënë dirigjenti i “Charitéchor Berlin”, Adrian Emans, i cili të shtunën mbrëma ka dirigjuar 29 anëtarët e korit që e udhëheq. Mbrëmja ka filluar me korin vendas.

“Come sweet death” e Bach me aranzhim të Rhonda Sandberg ka hapur mbrëmjen për të vazhduar me “Pakëz në ëndërr, pakëz në zhoëndërr” të Raki Iasharit me recitator Shahan Behramain. E

Arbëri.

Mustafa: Jam takuar me Kurtin për ta diskutuar platformën time për zhbllokimin institucional

Futboll.

Newcastle pëson debakël nga Leeds

Futboll.

Spektakël në Serie A, Interi fiton 5:3 ndaj Udineses

Futboll.

Kosova i luan 4 ndeshje brenda 16 ditësh grumbullim

Arbëri.

VV-ja pas tërheqjes së Sejdiut: Ishte mundësia që çështja e presidentit të zgjidhej, por u bllokua sërish

LAJMET E MBRËMJES.

Mbrojtja kërkon lirim të Thaçit e katër të tjerëve në rastin për pengim të drejtësisë

dyta është një dramë muzikore që “Siparantum” e ka me vete kudo që udhëton. “Purple rain” me aranzhim të Mac Huff, solist Erjon Palucajn e përcjellë në piano nga Denita Dedushaj ka ndërruar ngjyrat e koncertit, për të vazhduar me “Father thunder” të

Laura Jekabsone. Ambienti kishtar është pak i ngushtë për performancat lëvizëse të “Siparantum” por mesazhi arrihet. “Atsalums” e Jekabs Jančevskis me soprano Dea Musliun e tupan Fidan Strumcakun, bashkë me “Imagine” të John Lennonit, aranzhim të Mac Huff me soliste Klea Dinan, përcjellë në piano nga Agron Shujaku e kanë arritur efektin e vet. Njashtu sikurse “Fly to paradise” e Eric Whitacre me soliste sopranon, Elona Alshiqi.

“Po mundohemi që në këto ditë të zymta të sjellim art”, ka thënë në skenë dirigjenti e udhëheqësi i “Siparantumit”, Memli Kelmendi. Sipas tij, ardhja e një kori nga Gjermania ka rëndësi të veçantë.

Edhe



Kulturë • 23 gus 2026

“Siparantum” shton te medaljet e arta edhe dy të Malajzisë

“Është një punë e madhe e një mund i madh i yni që nëpërmjet artit të muzikës të krijojmë miqësi e të kemi në Pejë kore sikurse ky nga Berlini”, ka thënë Kelmendi.

Kori nga Gjermania ia ka mësyre skenës menjëherë pasi “Siparantum” ka përshëndetur publikun. Kanë nisur me “Baladën e fyellit” të Ramadan Sokolit për të vazhduar me “Ojjano” të Clifford W. King. Më pas kanë vazhduar me “Unsere Trübsal, die zeitlich und leicht ist” të Johann Ludwig Bach e “An den Sturwind” të Peter Cornelius. Ngjra e tyre muzikore është tjetër. e re për këto anë dhe në art kjo risi e bën edhe më të bukur praninë e një formacioni koral. Por muzika shqipe në koncertin e tyre qe e veçantë. “Në një çast ndershmerie” e Gjon Shllakut e “Vajta e rashë” e Prenkë Jakovës kanë bërë dallimin. Këtë e ka vërtetuar publiku. “Charitéchor Berlin” ka vazhduar me interpretime që mbajnë autorësi të krijuesve botërore si Clara Schumann e Torbjørn, Dyrud. “Me një lule” e Memli Kelmendit tashmë është në repertorin e tyre jo veç në Kosovë. Dhe këtu hyn në punë diplomacia kulturore që dirigjenti bashkë me “Siparantum” e ka arritur. Kur u themelua para një dekade, skeptikët kanë paraparë që ky formacion koral ndoshta do të mund të interpretonte gjer në fshatrat e Pejës. Por tash, “Siparantum” e ka çuar mbi 20 numrin e shteteve ku ka interpretuar sikurse atë që çmimeve. E Kelmendi krijimet e tij i ka në repertorë të disa koreve, prej të cilave një e vizitoi dhe koncertoi në Pejë. Kjo vepër e tij ka bashkuar dy koret në Pejë. Me një interpretim të përbashkët duke rrethuar publikun me mbi 60 veta, duke interpretuar dy formacionet korale kanë arritur efekt të veçantë nën dirigjimin e Kelmendit. Njashtu sikurse me dirigjimin e Adrian Emans kur bashkë kanë interpretuar “So wünsch ich ihr eine gute Nacht” të Frank Marin.

“‘Siparantum’ është një kor me shumë energji. Kanë zëra të mrekullueshëm dhe ne jemi tejet të kënaqur me këtë bashkëpunim”, ka thënë Emans. Në Pejë kanë zërkuar pas Shkupit dhe Shkodrës.

“Muzika në bashkon dhe ne synojmë që të bashkëpunojmë edhe më shumë në të ardhmen”, ka thënë ai. E dirigjenti Kelmendi ka përmendur se sivjet tri kore kishin adresë Pejën.

Edhe



Kulturë • 14 gus 2026

“Siparantum” drejt Malajzisë në festivalin ku bashkohen 200 kore

“Është dashur shumë punë intensive për ta arritur këtë. Por jemi krenarë që sado pak i kemi dhënë një zë muzikës shqipe e po ashtu edhe artistëve të rinj vendor. Misioni ynë vazhdon”, ka thënë ai. Në një mbrëmje pas koncertit, anëtarja e bordit të “Siparantum”, Shqipe Malushi u është drejtuar mysafirëve, duke thënë se arti është mjet për t’i bërë njerëzit që të shpërfaqin dashurinë njerëzore e jo thjesht ta thonë atë verbalisht, siç ngjan

ditëve të sotme.

“Pas përjetimeve e luftës ne na mbetet të tregojmë kulturën tonë, të kemi suksese dhe të jemi krenarë me ato”, ka thënë Malushi.

“Siparantum” mbase mund të kritikohet për shumë gjëra, por në ditët e sotme kur muzika korale nëpërmjet koreve vullnetare bën diplomaci kulturore nëpër botë, ky kor është “flamuri” i Kosovës në këtë aspekt. Dhe sidomos Peja, duhet ta shfrytëzojë këtë.

#KORI SIPARANTUM

#“CHARITÉCHOR BERLIN”

#PEJE

Artikuj të ngjashëm

- Kulturë • 1 maj 2026

“ARTyn” nga Lituania në Pejë, nikoqirët në luftë për merita dy ditë para koncertit
- Kulturë • 20 jan 2026

“Siparantum” akordohet për jubileun e themelimit
- Kulturë • 18 gus 2026

“DAM” kthehet me jubileun që bashkon të rinjtë, eksperimentimin dhe dialogun muzikor

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Perkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Marketing

Politika e privatesisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatesisë dhe cookies

+383 (0) 38 249 105 /

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.